



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE I NATIONAL AUDIT OFFICE			
16.07.2020			
DALLIMI MATRIKAL PËR BUREZAT DALLIMI MATRIKAL PËR BUREZAT			
QASUESI			
Numër Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot Prot. No	Nr. f. faqeje Sr. Stranica No. Pages
04	47	1087	2



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

<b>Për:</b>	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Kuvendi i Republikës së Kosovës Kuvendi Komunal
<b>Kopje elektronike:</b>	Bedri Hamza, Kryesues i KMFP dhe Koordinatorit të KMFP Hekuran Murati, Kryesues i KBT dhe Koordinatorit të KBT
<b>Nga:</b>	Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm, Republika e Kosovës
<b>SUBJEKTI:</b>	Raporti i auditimit për Komunën e Obiliqit për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2019

<b>Nr. Zyrës:</b> <b>No. de bureau:</b>	<b>Ext:</b> <b>Poste:</b>	<b>Data:</b> 16.07.2020
--	------------------------------	-------------------------

Data	Zyra e Pranimi	Komentet/Veprimet	Inicialet	Afati
		<p>Bashkangjitur mund të gjeni raportin e auditimit për Komunën e Obiliqit për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2019.</p> <p>Sipas nenit 23, pika 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, brenda 30 ditësh nga dita e pranimi të raportit final të auditimit, çdo institucion i audituar është i obliguar ta dorëzojë një Plan Veprimi ku përcakton se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport.</p>		







Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

<b>Za:</b>	Xhafer Gashi, Gradonačelnik Opštine Obilić Skupština Republike Kosova Skupština Opštine
<b>Elektronski primerak:</b>	Bedri Hamza, Predsedavajući KNJF i Koordinatora KNJF Hekuran Murati, Predsedavajući KBF i Koordinatora KBF
<b>Od:</b>	Besnik Osmani, Generalni Revizor, Republika Kosovo <i>B Osmani</i>
<b>PREDMET:</b>	Izveštaj revizije Opštine Obilić za finansijsku godinu završno sa 31 Decembrom 2019

<b>Br. Kancelarije:</b> <b>No. de bureau:</b>	<b>Ext:</b> <b>Poste:</b>	<b>Datum:</b> 16.07.2020
--	------------------------------	--------------------------

Datum	Prijemna kancelarija	Komentari/Radnje	Inicijali	Rok
		<p>U prilogu možete naći Izveštaj revizije za Opštine Obilić za finansijsku godinu završno sa 31 Decembrom 2019.</p> <p>Prema članu 23, stav 5 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnom Kancelariju Revizije, svaka revidirana institucija je obavezna da u roku od 30 od dana prijema završnog izveštaja podnese Akcioni Plan u kojem se određuje kako će adresirati preporuke koje su date u izveštaju.</p>		


Republika Kosovo - REPUBLIC OF KOSOVO  
Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije / NATIONAL AUDIT OFFICE

<small>Klasif. Kod Code</small>	<small>Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.</small>	<small>Nr. Fajcve Br. Stranica No. Pages</small>
---------------------------------	--	--






Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË  
KOMUNËS SË OBILIQIT PËR VITIN 2019**

Prishtinë, korrik 2020




Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Komunës së Obiliqit*, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.


Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Lavdim Maxhuni* udhëheqës i ekipit, *Ilir Abazi* dhe *Fetah Osmani* anëtarë të ekipës, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Shkëlqim Xhema*.





## TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore .....	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	19
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja.....	23
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	25



## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Obiliqit për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



### Konkluzionet

Procesi i përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore është menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Menaxhimi financiar dhe Kontrolli - edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive, dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: keq klasifikimi i shpenzimeve, menaxhimi i të hyrave, furnizimet përmes kontratave kornizë, mungesa e projekteve ekzekutive të investimet kapitale, ndarja jo e mirë e detyrave, menaxhimin e subvencioneve dhe shpalosje jo e saktë e llogarive të arkëtueshme.

Menaxhmenti kishte marrë masa sa i përket adresimit të rekomandimeve nga viti i kaluar. Prej 11 rekomandimeve të dhëna, tetë ishin zbatuar, një ishte në proces të zbatimit, një rekomandim është konsideruar i mbyllura, ndërsa një rekomandime nuk ishte zbatuar ende.

### Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm<sup>1</sup>

#### Opinion i pamodifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

### Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

## Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

# 1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

## Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

## Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës së Obiliqit dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimit si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna në përgjithësi ka të vendosur sistem të mirë të kontrolleve në raport me obligimet statutores të saj. Për vitin 2019 kishte shpenzuar 84% të buxhetit final ndërsa fushat kryesore ku nevojiten përmirësime, janë keq klasifikimi i shpenzimeve, menaxhimi i të hyrave, furnizimet përmes kontratave kornizë, mungesa e projekteve ekzekutive të investimit kapital, ndarja jo e mirë detyrave, menaxhimin e subvencioneve dhe shpalosje jo e saktë e llogarive të arkëtueshme.

#### 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>12,168,718</b>	<b>12,839,920</b>	<b>10,736,831</b>	<b>84%</b>	<b>6,387,148</b>	<b>5,870,255</b>
Granti i Qeverisë - Buxheti	11,072,293	11,072,294	9,849,471	89%	5,613,954	5,090,813
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup> -	0	706,752	398,312	56%	169,938	133,548
Të hyrat vetjake <sup>4</sup>	1,035,562	1,035,562	478,177	46%	530,367	548,797
Donacionet e brendshme	0	6,542	5,682	87%	18,705	5,842
Donacionet e jashtme	0	7,380	0	-	50,634	91,255
Të hyrat nga huamarrja	60,863	11,390	5,189	46%	3,550	0

<sup>2</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 671,202€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga vitit i kaluar me vlerë 706,753€, si dhe donacioneve të brendshme dhe të jashtme me vlerë 13,922€, ndërsa nga huamarrja ishte zvogëluar për 49,473€.

Në vitin 2019, Komuna e Obiliqit ka shpenzuar 84% të buxhetit final ose 10,736,831€, për dallim që në vitin 2018 shpenzimi ishte 87%. Megjithatë, se si është realizuar buxheti në nivel të kategorive, janë dhënë shpjegimet në tabelën më poshtë:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>12,168,718</b>	<b>12,839,920</b>	<b>10,736,831</b>	<b>84%</b>	<b>6,387,148</b>	<b>5,870,255</b>
Pagat dhe Mëditjet	4,078,259	4,123,259	3,908,949	95%	3,833,181	3,695,367
Mallrat dhe Shërbimet	723,930	750,562	717,363	96%	520,242	350,052
Shërbimet komunale	276,675	330,061	246,323	75%	148,160	167,628
Subvencionet dhe Transferet	832,800	836,210	632,161	76%	139,930	135,981
Investimet Kapitale	6,257,054	6,799,828	5,232,035	77%	1,745,635	1,521,227

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte rritur për 45,000€, nga të hyrat e bartura;
- Buxheti final në raport me atë fillestar për kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve ishte rritur për 26,632€ nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar;
- Te kategoria e Shërbimeve Komunale buxheti ishte rritur për 53,386€ nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar;
- Buxheti final te kategoria e subvencioneve ishte rritur gjithashtu nga të hyrat e bartura për 3,410€; dhe
- Buxheti final në raport me atë fillestar te kategoria e Investimeve Kapitale ishte rritur për 542,774€. Kjo rritje ishte një pjesë nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar në vlerë 528,852€, ndërsa pjesa tjetër nga bashkëfinancimet dhe donacionet e jashtme. Niveli i shpenzimit 77%, ishte për shkak të problemeve pronësore juridike tek asfaltimi i disa rrugëve si dhe ankesave në OSHP.



Lidhur me klasifikimin e shpenzimeve ne kemi trajtuar çështjen si në vijim:

---

#### Çështja B1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike

**Gjetja** Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Gjatë vitit 2019 komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 12,528€ në kategori ekonomike jo adekuate si në vijim:

- Në një rast në vlerë 8,441€ ishte paguar nga kategoria ekonomike investime kapitale megjithëse për nga natyra i përkiste kategorisë mallra dhe shërbime si p.sh: (Mirëmbajta dhe rregullimi i hapësirave publike si mbledhja e mbeturinave etj.); dhe
- Në dy raste komuna ka paguar pagat jubilarë për punëtorët e pensionuar në vlerë 4,087€ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Sipas komunës këto janë pasojë e buxhetit të kufizuar për mallra dhe shërbime, dhe pamundësisë që pagat jubilarë të paguhen nga buxheti i pagave dhe mëditjeve.

**Ndikimi** Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, ndikojnë në keq klasifikimin e shpenzimeve në Pasqyrat Financiare të Komunës dhe si të tilla japin informata jo të sakta për shfrytëzuesit e PFV-ve.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinin të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

## 2.1.1 Të hyrat

Buxheti i planifikuar i të hyrave vetanake për vitin 2019 ishte 1,035,562€, kurse realizimi ishte në vlerë prej 972,594€. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë, të hyrat nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar edhe të hyra nga gjobat nga trafiku, në vlerë totale prej 111,142€, këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat tatimore	559,323	559,323	485,616	87%	431,175	333,395
Të hyrat jo tatimore	476,239	476,239	486,978	102%	486,100	558,453
<b>Totali</b>	<b>1,035,562</b>	<b>1,035,562</b>	<b>972,594</b>	<b>94%</b>	<b>917,275</b>	<b>891,848</b>

Vlen të theksohet se këtë vit krahasuar me vitin e kaluar komuna ka realizuar më shumë të hyra prej 55,319€ apo shprehur në përqindje 6%. Rritja më e theksuar është tek tatimi në pronë dhe taksa për ushtrimin e veprimtarive. Lidhur me testet tona, ne kemi vërejtur si në vijim:

### Çështja A1 – Mos pagesa e taksës për ushtrimin e veprimtarisë

**Gjetja** Sipas rregullores (KO) Nr.2/2018 për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, neni 7. Gjobat, pika 2 përcakton që, ndaj subjektit afarist i cili nuk bënë pagesën e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste për vitin fiskal sipas afateve, do të iniciohet procedurë gjyqësore në Gjykatën kompetente për ekzekutim të dhunshëm.

Gjatë testimit në 13 raste kemi vërejtur që subjektet afariste prej shumës së faturuar në vlerë 25,340€ kishin paguar vetëm 2,940€ për taksën e ushtrimit të veprimtarisë afariste. Për këto, komuna ka lëshuar vërejtjet e fundit tek shtatë biznese me borxhe më të larta<sup>5</sup>, por me pastaj nuk ka vazhduar me procedura të mëtejme të kërkuara me rregullore që të iniciohet në procedurë gjyqësore për ekzekutim të dhunshëm.

Në anën tjetër komuna është arsyetuar, që nuk ka vepruar sipas rregullores me qëllim që të mos ndikojnë në mbarëvajtjen e punës së bizneseve.

**Ndikimi** Mos ndërmarrja e masave të kërkuara nga komuna ndaj subjekteve afariste për vonesat e pagesave për taksa për ushtrimin e veprimtarisë ndikon që të hyrat e planifikuara nga këto taksa të mos arkëtohen duke reduktuar edhe mundësin e financimit të projekteve të planifikuara nga të hyrat vetanake.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të siguroj që nga drejtoria përkatëse janë ndërmarr të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj subjekteve afariste të cilët nuk i përmbushin obligimet dhe të inicohen procedura gjyqësor nëpërmes gjykatës apo përmbaruesve për t'i mbledhur ato.

## 2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Paga e Mëditje ishte 4,123,259€, ndërsa ishin shpenzuar 3,908,949€ apo 95% e buxhetit. Numri i planifikuar i punëtorëve me buxhetin e vitit 2019 ishte 645, ndërsa në fund të vitit numri i të punësuarve ishte 706. Dallimi në mes të numrit aktual dhe të planifikuar është për arsye të angazhimit të punonjësve arsimor në rastet e zëvendësimit të pushimeve të lehonisë dhe numrit të deputetëve të kuvendit komunal.

Gjate vitit 2019 ishin punësuar 40 punëtor, ku 11 prej tyre ishin të punësuar për kohë të caktuar. Përmes procedurave të rekrutimit, gjatë vitit 2019 ishin angazhuar 31 punonjës me marrëveshje të shërbimeve të veçanta, të cilat gjatë vitit 2020 ishin ndërprerë.

Për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ne kemi testuar 32 mostrat për teste substanciale në vlerë 15,702€, si dhe 12 mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

<sup>5</sup> Komuna ka lëshuar vërejtjet e fundit ndaj shtatë bizneseve që kanë borxhe më të mëdha, Komuna ndaj njërit biznes nuk ka lëshuar vërejtjen edhe pse ka pasur një borxh prej 5,000 €, me arsyetimin se është në proces të falimentimit. Kurse ndaj pesë bizneseve të tjera Komuna nuk ka bërë vërejtje sepse ato i kanë kryer disa pagesa dhe kanë pasur borxhin më të ulët.

### 2.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti për mallra dhe shërbime përfshirë edhe shërbime komunale ishte 1,080,623€, prej tyre ishin shpenzuar 963,687€. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me shërbime kontraktuese tjera, mirëmbajtje e rrugëve lokale, karburante, shpenzime komunale, furnizime mjekësore, etj. Për këtë kategori ekonomike kemi testuar 28 mostra për teste substanciale në vlerë totale 208,886€ dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

#### Çështja A2 - Tejkallim i limiteve të porosisë përtej 30% për kontratën publike kornize

**Gjetja** Pika 56.10 e Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, përcakton se: Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Gjatë testimit të pagesës për furnizim me material laboratorik në vlerë prej 4,000€, kemi vërejtur që Komuna ka tejkalluar sasinë e porosive nga norma e lejuar prej 30% mbi sasinë e kontraktuar, te pozicionet si në vijim:

- Pozicioni 24. Test Tube, sasia e kontraktuar ishte 1500 copë, ndërsa janë furnizuar 2000 copë apo 33.33% duke tejkalluar limitin për 500 copë apo 3.33%; dhe
- Pozicioni 29. Vazhduese të micropipetave 5-50, sasia e kontraktuar ishte 750 copë ndërsa furnizuar 2400 copë apo 220% duke tejkalluar limitin për 1,650 copë apo 190%.

Vlera e tejkalluar sasive të kontraktuara për dy pozicionet ishte 603€. Shkaku përse ka ardhur deri te kjo, janë kontrollet e mangëta dhe planifikimet jo të drejta rreth nevojave vjetore për material mjekësor.

**Ndikimi** Dobësitë në furnizime duke tejkalluar sasinë e kontraktuara përtej normave të lejuar për disa produkte do të ndikojë negativisht dhe do të pamundësojë furnizimin e produkteve tjera të nevojshme.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese bëjnë planifikime më reale të nevojave për furnizim, dhe se menaxherët e kontratave nuk lejojnë furnizimin përtej limiteve të përcaktuara me kontratën publike kornizë.

## 2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 836,210 €, prej tyre ishin shpenzuar 632,161€. Subvencionet janë dhënë kryesisht për përfitues individual, por edhe për entitete publike dhe entitete jo publike, për qëllime shëndetësore, kulturore, arsimore, rini dhe sport. Komuna kishte përgatitur planin vjetor si dhe raportin vjetor për projektet e subvencionuara.

Për këtë kategori kemi testuar 15 mostra për teste substanciale ne vlere totale 108,180€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë në vlerë totale 121,199€. Mangësitë e identifikuara kanë të bëjnë:

### Çështja A3 - Mangësi në procedurën e subvencionimit

**Gjetja** Rregullore MF - Nr - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, përcakton që thirrja publike duhet të jetë e hapur për së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë pune (neni 12, pika 3) dhe se përfituesit duhet të dëshmojnë pagesën e obligimeve tatimore. (Neni 20, pika 3)

Nga shqyrtimi i lëndës/subvencionimit për ngritjen e kujdesit shëndetësor me vlerë 56,070€, kemi konstatuar se thirrja publike ishte bërë për afatin 7 ditë, ndërsa nuk ishte kërkuar që përfituesi të dëshmojë pagesën e tatimeve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrollit dhe monitorimit jo të mirë të zyrtarëve përgjegjës në thirrjen publike dhe përcaktim të kriterëve për subvencionim.

**Ndikimi** Thirrja publike dhe mos përcaktimi i drejtë i kriterëve sipas rregullores mund të ndikoj që OJQ-të përfituese të mos kenë përmbushur detyrimet tatimore dhe të mos jenë informuar sa duhet për procesin e subvencionimit.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë që procesi i subvencionimit përmes thirrjes publike dhe përcaktimi i kriterëve bëhet në përputhje me afatet dhe kërkesat e rregullores për subvencionimin e OJQ-ve.

## 2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,799,828€, prej tyre për vitin 2019 ishin shpenzuar 5,232,035€. Investimet kapitale kanë të bëjnë kryesisht me rregullim të infrastrukturës, qendrave sociale, si dhe përmirësime të ndryshme tek objektet dhe inventari etj.

Për këtë kategori, ne kemi testuar 50 mostra për teste substanciale në vlerë prej 2,855,398€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

### Çështja A4 - Mungesa e projekteve ekzekutive me rastin e lëshimit të dosjes së tenderit

**Gjetja** Sipas ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 28, pika 10, përcakton për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë, autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutiv dhe nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në lidhje me këtë, ne kemi vërejtur se komuna gjatë vitit 2019 kishte nënshkruar 9 kontrata për punë, në mungesë të projekte ekzekutive. Shkaku i ndodhjes së kësaj sipas zyrtarëve përgjegjës ishte se deri në muajin prill të vitit 2019 Komuna nuk kishte pasur kontratë për hartimin e projekteve ndërsa procedurat e prokurimit kishin filluar në fillim të vitit.

**Ndikimi** Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv rezulton me anashkalim të kërkesave të ligjit të prokurimit dhe mund të ndikoj me realizim të dobët të kontratave për punë si dhe mund të afektojnë shpenzim të paparashikuar apo vlerë të dobët për parane e shpenzuar.

**Rekomandimi A4** Kryetari të siguroj që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht se njësitë kërkuese kanë të hartuar projektin ekzekutive në përputhje me nevojat dhe kërkesat e ligjore.

## Çështja A5 - Ndarje jo e duhur e detyrave të punës

**Gjetja** Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, te neni 62 përcaktohet se një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose termat e referencave, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura është e ndaluar që të nënshkruaj pranimin e mallrave.

Në lidhje me këtë te kontrata për blerjen e autoambulancave me vlerë 79,900€ zyrtari përgjegjëse që kishte hartuar specifikat teknike kishte marrë pjesë edhe në pranimin teknik të pajisjeve (autoambulancave në cilësinë e kryetarit të komisionit).

Shkaku i ndodhjes së kësaj ishte kujdesi jo i duhur i zyrtarëve përgjegjëse për të eliminuar situatën e tillë.

**Ndikimi** Dobësitë në ndarjen e detyrave dhe mos zbatimi i rregullave dhe udhëzimeve të prokurimit publik gjatë procesit të prokurimit, ndikon në shkeljen e parimeve të ndarjes së duhur të detyrave që ka për qëllim shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të siguroj se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit, për shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm.

## 2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 49,718,011€, pasurive jokapitale është 317,627€, si dhe e stoqeve 129,134€. Për pasuritë, ne kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë prej 3,374,691€, si dhe në aspektin e pajtueshmërisë kemi kryer testet sipas programit të auditimit.

## 2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,049,469 €. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në prone në vlerë prej 648,840 €, taksat ne biznes prej 97,580 € dhe të nga të hyrat e tjera në vlerë prej 303,049€.

Lidhur me menaxhimin e të arkëtueshmeve, ne kemi vërejtur si në vijim:

### Çështja C1 -Shpalosje jo e saktë e vlerës së llogarive të arkëtueshme në PFV

**Gjetja** Sipas Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

- Komuna nuk ka harmonizuar saldot përfundimtare të kartelës së llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë me saldot fillestare, andaj në PFV, kjo llogari ishte e mbi vlerësuar për 50,714€; dhe
- Nuk i ka prezantuar fare llogaritë e arkëtueshme nga taksa për leje të ndërtimit që duhet paguar pas vitit 2019 (këstet e papaguara) në vlerë prej 50,772€.

Mospërputhja e saldove të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë, është për arsye se Komuna i ka pranuar (gjeneruar) nga sistemi i tatimin në pronë në fund të vitit këto saldo ndërsa mos prezantimi i borxheve nga këstet e papaguara pas vitit 2019, për taksën për leje të ndërtimit ka ndodh për arsye të mos harmonizimit të saldove dhe komunikimit të jo të duhur në mes të Drejtorive (Urbanizmit dhe Financave).

**Ndikimi** Dobësitë e identifikuar në shpalosjet e llogarive të arkëtueshme, ndikojnë në shpalosjen apo prezantimin e informatave jo të sakta për vlerën e tyre në PFV. Njëherit, diferencat e tilla ndikojnë edhe në planifikimet e projekteve të cilat do të mund të planifikoheshin në bazë të efikasitetit të mbledhjes së tyre nga Komuna.

**Rekomandimi C1** Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara në bazë të faturimeve dhe që vlera e tyre shpaloset saktë në PFV pas harmonizimit të regjistrave nga drejtoritë përkatëse me ZKF-në.



## 2.4 Detyrimet

### 2.4.1 Detyrimet e papaguara

Vlera e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 41,414€<sup>6</sup>. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Në raport me vitin 2018, komuna ka treguar progres në menaxhimin e faturave të papaguara, duke reduktuar dukshëm obligimet në fund të vitit (obligimet e papaguara në fund të vitit 2018 ishin 151,991€).

Ne për këtë llogari kemi testuar 5 mostra dhe nga testet e kryera nuk kemi ndonjë të gjetur tek kjo llogari.

### 2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019, ishte 1,651,292€. Prej kësaj vlere, shumica e lëndëve kanë të bëjnë me pagesën e pagave, kurse lëndët tjera kanë të bëjnë me çështjet pronësore dhe administrative. Ne për këtë llogari kemi testuar 5 mostra dhe nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur në raport.

### 2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Detyrimet kontraktuale të raportuara nga ana e Komunës në fund të vitit 2019 janë në vlerë prej 1,009,779€<sup>7</sup>.

## 2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon një auditor i cili është edhe drejtor i njësisë. Në Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2019, kishte planifikuar gjashtë (6) auditime të rregullta në bazë të vlerësimit të rreziqeve dhe prioriteteve. Prej tyre kishte arrit që t'i përfundoj katër auditim, këto auditime kishin të bënin me aktivitetet e vitit 2018 dhe 2019.

Komiteti i Auditimit (KA), gjatë vitit 2019 kishte mbajtur gjashtë takime ku janë shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së, dhe është diskutuar për raportet e ZKA-së.

<sup>6</sup> Kjo shumë e obligimeve i përfshin: mallra dhe shërbime prej 23,358€, shpenzime komunale prej 18,056€, vlerë kjo e shpалosur nga komuna e Obiliqit.

<sup>7</sup> Kjo vlerë është ofruar nga komuna e Obiliqit, është vlerë të cilën ne nuk kemi arritur të auditojmë.

### 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 kishte rezultuar me 11 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Ajo ka dorëzuar Reportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, prej 11 rekomandimeve nga viti i kaluar tetë (8) ishin zbatuar, një (1) ishte në proces të zbatimit, një (1) rekomandime e konsiderohen të mbyllura, ndërsa një (1) rekomandime nuk ishte zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pasqyrat Financiare Vjetor	Kryetari duhet të angazhohet që gjatë planifikimit të buxhetit për organizatën të vlerësohen nevojat reale të komunës me qëllim që të bëhet një planifikim adekuat i buxhetit dhe të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve nëpër kategori përkatëse ekonomike.	Edhe në këtë vit kemi identifikuar keq klasifikim të shpenzimeve shih çështjen B1.	I përsëritur.
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2017 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2018. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Ndërsa, planifikimi dhe shpenzimi për projekteve të caktuara duhet të bëhet konform kodeve ekonomike të ndara për kategori përkatëse varësisht përfitimeve.	Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim dhe e kishte rritur përqindjen e realizimit të buxhetit në këtë vit.	I zbatuar.
3		Kryetari, duhet të siguroj kontrole, përgjegjshmëri më të lartë ndaj kryerjes së obligimeve me kohë ndaj operatorëve, si dhe të shmang hyrjen në obligime në mungesë të mjeteve apo kontratës. Gjithashtu, gjatë planifikimit buxhetor, të bëhet një vlerësim i shumave të mundshme të	Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim dhe në këtë vit nuk kishte raste të tilla.	I zbatuar.

		daljes së parasë nga kontestet gjyqësore dhe këto të planifikohen në kuadër të buxhetit vjetor, në mënyrë që mos të rrezikohet realizimi i projekteve tjera të planifikuara.		
4	Pagat dhe Mëditjet	Kryetari të sigurojë se janë dizajnuar kontrollet e duhura në mënyrë që rekrutimet të behën përmes një procesi transparent, konkurrues dhe në pajtim me kërkesat ligjore. Në rastet kur ka deficit të burimeve njerëzore, kjo duhet të konsultohet me organet përkatëse qendrore (ministrinë përkatëse) dhe rastet e tilla të rregullohen përmes bazës rregullative.	Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim dhe në këtë vit nuk kishte raste të tilla.	I zbatuar.
5	Paga dhe Mëditje	Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.	Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim dhe në këtë vit nuk kishte raste të tilla.	I zbatuar.
6	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë mjetet e nevojshme për realizimin e projekteve, në anën tjetër të konsideroj se punëve shtesë iu paraprinë aneks kontrata që përcakton saktë kushtet dhe çmimet e punëve apo shërbimit të përfituar	Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim dhe në këtë vit nuk kishte raste të tilla.	I zbatuar.
7	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë se menaxheret e projektit kërkojnë nga kontraktuesit aplikimin e librit ndërtimor, si mjet për ndërtim dhe zhvillim të projektit.	Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim dhe në këtë vit nuk kishte raste të tilla	I zbatuar.
8	Investimet kapitale	Kryetari të siguroj se para fillimit të procedurave të janë planifikuar projektet në tërësi, të zgjidhen të gjitha çështjet pronësore, në mënyrë që të mos ketë ngecje të projekteve dhe të pa realizuara.	Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim dhe në këtë vit nuk kishte raste të tilla	I zbatuar.
9	Llogarite arkëtueshme	Kryetari duhet të analizojë arsyet për trendin në rritje të arkëtueshmeve të tatimit në pronë dhe për të forcuar	Komuna kishte marrë masa pjesërisht për këtë.	Pjesërisht i zbatuar.

		<p>kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtejshme. Është e nevojshme të krijohet një strategji dhe mekanizma për të mundësuar identifikimin dhe mbledhjen e borxheve të akumuluarra përmes futjes së kushtëzimit të disa shërbimeve komunale bazuar në evidencën e tatimit në pronë të paguar. Gjithashtu, është e nevojshme që Komuna të menaxhojë llogaritë e arkëtueshme të taksës së biznesit, në mënyrë adekuate. Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Po ashtu komuna duhet të shqyrtojë mundësinë e përdorimit të një softueri për menaxhimin e tyre.</p>	<p>Ne kemi vërejtur që ka dobësi në harmonizimin dhe prezantimin e llogarive në PFV. Shih çështjen C1.</p>	
10	Sistemi i auditimit të brendshëm	<p>Kryetari duhet të konsiderojë që me krijimin e kushteve buxhetore, të planifikojë staf shtesë në NjAB me qëllim të funksionalizimit të plotë të kësaj njësie dhe të realizimit të planit vjetor. Njëkohësisht, që NjAB të përfshijë më shumë auditime me qëllim të përmirësimit të efikasitetit në procesin e menaxhimit të rrezikut, kontrolleve dhe qeverisjes.</p>	<p>Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim ku gjatë procesit të auditimit e kishte shpallur konkursin për auditor të brendshëm.</p>	I zbatuar.
11	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	<p>Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit për projekte kapitale, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve</p>	<p>Kjo çështje nuk do të trajtohet në raportin e auditimit për vitin 2019.</p>	I mbyllur.

		me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.		
<b>Nr.</b>	<b>Fusha e auditimit</b>	<b>Rekomandimet e vitit 2019</b>		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinin të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.		
2	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që nga drejtoria përkatëse janë ndërmarrë të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj subjekteve afariste të cilët nuk i përmbushin obligimet dhe të inicohen procedura gjyqësorë nëpërmes gjykatës apo përmbauesve për t'i mbledhur ato.		
3	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese bëjnë planifikime më reale të nevojave për furnizim, dhe se menaxherët e kontratave nuk lejojnë furnizimin përtej limiteve të përcaktuara me kontratën publike kornizë.		
4	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që procesi i subvencionimit përmes thirrjes publike dhe përcaktimi i kriterëve bëhet në përputhje me afatet dhe kërkesat e rregullores për subvencionimin e OJQ-ve.		
5	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht se njësitë kërkuese kanë të hartuar projektin ekzekutiv në përputhje me nevojat dhe kërkesat e ligjore.		
6		Kryetari duhet të sigurojë se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit, për shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm.		
7	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara në bazë të faturimeve dhe që vlera e tyre shpaloset saktë në PFV pas harmonizimit të regjistrave nga drejtoritë përkatëse me ZKF-në.		

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keq deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keq deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keq deklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2)

nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letër e Konfirmimit



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

### LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kemi ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. Xhafer Gashi 

Kryetar i Komunës së Obiliqit

Data: Obiliq



Dalës-Izleza

Nr. -11-845  
Br.

Data 03.08.2020  
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova



---

Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z.Xhafer Gashi, kryetar i komunës së Obiliqit

Plani i veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve për vitin 2019

03.08.2020

Obiliq



## Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit (ZKA), për Komunën e Obilqit, viti financiar 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimi i menaxhmentit	Koha e planifikimit	Drejtoria/Zyrtari përgjegjës
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuata të buxhetit apo ridentimim të mjeteve dhe që pagesa dhe rexhistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuata.	Janë ndërmarr masa dhe planifikimi është bërë konform kodeve ekonomike	E plotësuar	DKA, DEFZH, DMM
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari, duhet të sigurojë që nga drejtoria përkatëse janë ndërmarr të gjitha masat në pajtim me ligjin ndaj subjekteve afariste të cilar nuk i përmbushin obligimet dhe të inicohen procedura gjyqësore nëpërmes gjykatave apo përmbauresve privat për ti mblledhur të hyrat vetanake.	Në vitin 2020 jemi duke bërë përgatitjet për fillimin e procedurave përmbaimore	Pjesërisht	DEFZH dhe drejtoritë përkatëse
3	Mallrat dhe Shërbimet	Kryetari të sigurojë se njësitë kërkuese bëjnë planifikime më reale të nevojave për furnizim dhe se menaxherët e kontratave nuk lejojnë furnizime përtej limiteve të përcaktuara me kontratën publike kornizë.	Janë ndërmarr masa dhe në vitin 2020 nuk kemi pasur raste të tilla	E plotësuar	DSHMS si dhe drejtoritë tjera
4	Subvencionet dhe Transferet	Kryetari, duhet të sigurojë që procesi i subvencionimit përmes thirrjes publike dhe përcaktimi i kriterëve të bëhet në përputhje me afatet kohore dhe kërkesat e rregullores për subvencionimin e OJQ-ve.	Në vitin 2020 ky rekomandim është në përputhje me afatet kohore dhe sipas Rregullores për Subvencionimin e OJQ-ve.	E plotësuar	DSHMS si dhe drejtoritë tjera
5	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht se njësitë kërkuese kanë hartuar projektin ekzekutiv në përputhje me nevojat dhe kërkesat ligjore.	Ky rekomandim është marrë parasysh dhe në vitin 2020 kemi kompaninë e kontraktuar për hartimin e projekteve ekzekutive	E plotësuar	Zyra e prokurimit dhe drejtoritë komunale.
6		Kryetari të sigurojë se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit, për shmangien e çfardo konfliktit të mundshëm	Ky rekomandim është marrë parasysh dhe në vitin 2020 nuk kemi raste të tilla	E plotësuar	DSHMS, drejtoritë përkatëse dhe menaxherët e projekteve.
7	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të ndërmarr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara në bazë të faturimeve dhe që vlera e tyre shpaloset saktë në PFVpas harmonizimit të regjistrave nga drejtoritë përkatëse me ZK-F-në.	Në vitin 2020, sa i përket llogarive të arkëtueshme nga taksat komunale, rekomandimi i tillë nuk do të përsëritet kurse sa i përket llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë do të ndërmërren masa për tatimin në pronë do të departamentin e tatimit në pronë.	Pjesërisht	DEFZH/DPUPK

Kryetari i Komunës

Xhatër Gashi



